Tiranë, me 25.04.2024

**AKT Themelimi**

I shoqërisë tregtare **"Quantum Collateral Facilities Shpk"**

Sot me datë 25.04.2024 mbeshtetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr. 9901, datë. 14.04.2008 "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" i ndryshuar dhe të ligjit 131/2015" Për Qëndrën Kombëtare të Biznesit" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tij të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi nga ortaku i vetëm ;

1: **BENITO DOQI**, I biri I Xhon dhe I Maria, I dtl 13.10.1969, shtetas i Maqedonisë së Veriut, lindur dhe banues në Shkup-Butel, Rr. "Bosnje & Hercegovina", Nr. 2913-10, Maqedoni e Veriut, me gjëndje civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. N0367441 me Nr. Përsonal Identifikimi 1310969450103, zotëron një kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, kryesisht në vlerë nominale 100.000 ( një qind mijë) LEKË.

**Formulimi**
**Neni 1**

Formohet shoqëria tregtare **"QUANTUM COLLATERAL FACILITIES" Shpk.**
Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarine e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

**Selia e Shoqërisë**
**Neni 2**

Selia e Shoqërisë **QUANTUM COLLATERAL FACILITIES" Shpk** ndodhet ne adresen. **Rr. "Abdi Toptani" Torre Drin, Kati i II, Tiranë, Shqipëri.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve .

**Objekti i Veprimtarisë**
**Neni 3**

Objekti aktivitet i shoqërisë do të jetë të kryejë çdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, veçanerisht sa më poshtë: Shoqëria ka për qëllim ushtrimin e aktiviteteve si më poshtë:

Benito Doqi

-Promovimi i biznesit, tregtisë dhe i ndërveprimeve të tjera tregtare.
-Promovimi i investimeve ne Shqipëri dhe Investime në fusha të ndryshme në Shqipëri.
-Veprimtari ekonomike në fushën e real estate (pasurive të paluajtshme), që ka të bëje me negociata, ndermjetësime, perfaqësime të të tretëve në fushën e real estate si në tregun e brëndshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Shitje, blerje, dhenie me qira të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, brënda dhe jashtë vendit, si dhe çdo transaksion tjetër në funksion të përmbushjes së objektit të veprimtarisë në fushën e real estate.
-Investime të tjera private.

**Kohezgjatja e Shoqërisë**
**Neni 4**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkaku .

**Kapitali i Shoqërisë**
**Neni 5**

Kapitali fillestar i shoqërisë është i shprehur në kapital në para, 100.000 ( njëqind mijë) LEKË, i cili do te përdoret si kapital i shoqërise.

Ky kapital eshte i barabarte me 1 (Një) Kuotë. **BENITO XHON DOQI** përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqëriseë. Kontributet mund të bëhen në natyrë dhe në vlerë monetare, në përputhje me ligjin.

Kapitali i Shoqërisë do të shlyhet nga Ortaku, në proporcion me pjesën e tij takuese.
Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar )

**Drejtimi i Shoqërisë**
**Neni 6**

Shoqeria drejtohet nga Administratori/et. Administratori/et mund të jenë të çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidentë në Shqipëri.

Neni 6.1
Kohëzgjatja e funksionit te Administratorit/eve eshte per nje periudhe prej 5 vjetesh, me të drejtë rinovimi kontrate për periudhe të ngjashme kohore, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë

Benito Doqi

merr fuqi ligjore (dmth regjistrimi pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit), me të drejte ripërtëritje të ketij mandati.

**Neni 6.2**
Administratori është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj konform legjislacionit ne fuqi.

**Neni 6.3**
Çdo kontratë do të kryhet prej tij, në mungesë nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme .

**Neni 6.4**
Të ardhurat neto i takojnë ortakut/ëve të shoqërisë .

**Neni 6.5**
Konfliktet që mund te lindin, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen në zbatim te legjislacionit shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 6.6**
Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me logon dhe tekstin brenda saj.

**Neni 6.7**
Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe ne përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanarisht të ligjit Nr.9901, date14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" I ndryshuar, si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e Shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.

**Neni 6.8**
Akti i themelimit , u përpilua në 5 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **Quantum Collateral Facilities" Shpk.** Akti i Themelimit u nënshkrua rregullisht nga ortaku i vetëm shoqërisë.

**ORTAK I VETËM I SHOQËRISË**

**"Quantum Collateral Facilities" Shpk.**

**BENITO XHON DOQI**

Benito Doqi